**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**
**DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 842 Prot., Tiranë, më 18.05.2026

**Lënda:** Dërgohet raporti për 4-mujorin e parë të vitit 2026 mbi monitorimin e buxhetit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

**MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**
Rruga "Dëshmorët e 4 shkurtit", Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 *"Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore"*, shtojca 3, po ju paraqesim informacionin narrativ mbi monitorimin e buxhetit për periudhën janar – prill 2026, për AIDA-n.

- *Hyrje.*

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe Mënyrën e Funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

## *1.Informacioni buxhetor i agreguar*

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. 87/2025 *"Për buxhetin e vitit 2026"*, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 *"Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, të udhëzimit nr.14, datë

30.05.2023 *"Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore"*, ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 *"Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"(AIDA),* gjatë periudhës raportuese janar – prill 2026, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

***A. Buxheti i Shtetit*** në masën **233,345,000 lekë**, nga të cilat:

- në masën 224,895,000 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht;

*- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;*
*- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,*

- 8,450,000 lekë për shpenzime për investime me kapital të brendshëm.

Fondet në fjalë gjatë periudhës raportuese kanë pësuar këto shtesa:

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) me nr.1138/2 prot., datë 2.03.2025, protokolluar këtu me nr. 997, datë 03.04.2025, "Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e veçantë" është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën **100,000 lekë.**
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) me nr. 3212/1 prot., datë 21.04.2026, "Miratim për transferim fondi në shpenzime korente për vitin 2026, program 04130", është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 602 0000 në masën **12,000,000 lekë.**

***B. Financim i huaj***

Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) nr.139/8 prot., date 07.04.2026 "Detajim pjesor i buxhetit 2026-2028 për shpenzime kapitale" është detajuar buxheti i planifikuar për vitin 2026 për investimet me kapital të huaj nga financimet e huaja në masën 3.000.000 lekë. Projekti në ndjekje nga AIDA është projekti EEN Albania.

Gjatë vitit 2025 AIDA nënshkroi marrëveshjen e grantit për projektin nr.101236267 – EEN Albania me agjencinë ekzekutive EISMEA, që mbështet zbatimin e SMP-së. Kontrata është efektive nga data 1 korrik 2025 deri më 30 qershor 2028, me një vlerë totale prej 360,499.95 euro. Më 23 korrik 2025, në llogarinë e parafinancimit të hapur pranë Bankës së Shqipërisë është transferuar këstit i parë prej 90,124.99 euro. Për AIDA-n (koordinatore e projektit) pjesa takuese është në vlerën 23,973.40 Euro ose 2,325,419.8 lekë ndërsa pjesa tjetër ju transferua partnerëve.

Në përfundim të periudhës raportuese, rezulton se fondi faktik i parashikuar për AIDA-n është në total në masën **248,445,000 lekë**. *(245,445,000 lekë financim nga Buxheti i Shtetit dhe 3,000,000 lekë Financim i huaj)*

- **Performanca e AIDA-s gjatë periudhës raportuese Janar – Prill 2026**

Gjatë periudhës janar – prill 2026, AIDA ka shënuar rritje në nivel performance, si në aktivitetet përfaqësuese me palë të treta, ashtu edhe në përkrahjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

**a) Performanca e produktit: "*Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit*".**

Gjatë periudhës janar – prill 2026, AIDA ka realizuar aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave dhe funskioneve të veta, si më poshtë:

*1.Pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare.*

- **Në kuadër të promovimit të kompanive shqiptare në tregjet e huaja dhe me synim nxitjen e eksportit, AIDA ka marrë pjesë me stende në disa panaire ndërkombëtare:**

• **"Biofach 2026", datat 10-13 Shkurt 2026, Nuremberg, Gjermani**
Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 4 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 250 kontakte me kompani të huaja.

• **"Food Expo", në datat 14-16 mars 2026, në Athinë.**
Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i verës dhe një kompani e kafes, një komapni mga sektori turshive te perimeve, 1 kompani nga sektori i Vajit të ullirit dhe një kompani nga sektori i Lëngjeve organike të frutave. Kompanitë realizuan 231 kontakte me kompani të huaja.

- **Në kuadër të nxitjes së investimeve të huaja, zhvillimin e potencialeve turistike në vend dhe promovimin e Shqipërsië, AIDA ka marrë pjesë më stendë, në disa panaire ndërkombëtare:**

• **'ITB Berlin", në datat 3-5 mars 2026, Berlin, Gjermani**
ITB Berlin (Internationale Tourismus-Börse Berlin) është një nga panairet më të mëdha dhe më të rëndësishme të turizmit në nivel global, i cili mbledh çdo vit profesionistë, institucione dhe kompani lider nga industria e turizmit dhe mikpritjes. Panairi shërben si një platformë strategjike për promovimin e destinacioneve turistike, zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe prezantimin e tendencave më të fundit në sektorin e turizmit.
Në këtë edicion të panairit morën pjesë përfaqësues të industrisë së turizmit nga vende të ndryshme të botës, përfshirë struktura akomoduese, operatorë turistikë, agjenci udhëtimi, linja ajrore, platforma digjitale, institucione publike dhe organizata të promovimit të turizmit. Panairi ofroi mundësi të rëndësishme për rrjetëzim profesional, zhvillim bashkëpunimesh dhe promovim të potencialeve turistike të vendeve pjesëmarrëse.
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në këtë vit në cilësinë e bashkë-ekspozuesit, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, me qëllim promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik dhe prezantimin e mundësive për investime në sektorin e turizmit dhe mikpritjes. Gjatë panairit u zhvilluan takime me përfaqësues të kompanive dhe institucioneve ndërkombëtare të interesuara për tregun shqiptar, si dhe u promovuan potencialet turistike, kulturore dhe investuese të vendit.

- **"Panairi i MIPIM", në datat 9-13 mars 2026, Kanë, Francë.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucioni kyç për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, mori pjesë në panairin MIPIM 2026, gjatë datave 9 – 13 Mars 2026.

MIPIM (Marché International des Professionnels de l'Immobilier) konsiderohet si një nga eventet më të mëdha dhe më prestigjioze në nivel global për industrinë e pasurive të paluajtshme dhe zhvillimit urban, duke mbledhur çdo vit investitorë, zhvillues, institucione financiare, kompani konsulence, arkitektë, autoritete publike dhe përfaqësues të sektorit të real estate nga mbarë bota.

Në kuadër të pjesëmarrjes në këtë panair, AIDA zhvilloi një sërë takimesh me investitorë, zhvillues dhe operatorë ndërkombëtarë të sektorit të pasurive të paluajtshme, me fokus prezantimin e potencialeve investuese të Shqipërisë dhe avantazheve konkurruese që ofron vendi ynë. Gjithashtu, gjatë takimeve u prezantuan mundësitë për bashkëpunim dhe investim në tregun shqiptar, si dhe u promovuan politikat lehtësuese dhe klima e favorshme për investimet e huaja.

*2.Evente*

*- "Match Maker Albania 2026" me fokus nxitjen e investimeve*

Në muajin mars 2026, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi edicionin e dytë të Match Maker Albania 2026, një nga ngjarjet më të rëndësishme në vend për promovimin e investimeve, zhvillimin e partneriteteve ekonomike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Aktiviteti shërben si një platformë strategjike që synon të lidhë investitorët e huaj me mundësi konkrete investimi në Shqipëri, duke krijuar hapësira për takime direkte B2B (Business to Business) dhe B2G (Business to Government).

Edicioni i dytë i eventit u organizua përmes katër zonave tematike kryesore, të fokusuara në sektorë me potencial të lartë zhvillimi dhe interesi për investime:

- Future Estate - Në këtë zonë u prezantuan 20 projekte konkrete – 15 private dhe 5 shtetërore – duke ofruar një pasqyrë të qartë të transformimit urban dhe turistik që po merr formë në Shqipëri.
- Power Next – Në këtë zonë u prezantua progresi i tranzicionit energjitik, si edhe u prezantuan investime dhe iniciativa nga një sërë kompanish.
- Smart Agriculture - Në këtë zonë u prezantuan zgjidhje inovative në agri-tech, duke reflektuar potencialin e inovacionit në sektorin bujqësor.
- Digital Horizons – Në këtë zonë u zhvilluan prezantime të drejtpërdrejta nga institucione, kompani dhe start up-e, ku u diskutua përdorimi i inteligjencës artificiale në shërbime publike, inovacioni në sektorët tradicionalë dhe transformimi digjital i bizneseve.

Këto zona shërbyen si pika të dedikuara ndërveprimi ndërmjet investitorëve, institucioneve publike, kompanive shqiptare dhe aktorëve të ekosistemit të biznesit, duke mundësuar prezantimin

e projekteve konkrete investuese, shkëmbimin e kontakteve dhe diskutimin e mundësive për bashkëpunim.

Fakte kryesore të eventit:

- Të pranishëm përfaqësues nga +40 shtete, duke reflektuar interesin e gjerë ndërkombëtar.
- Eventi mblodhi më shumë se 1,200 pjesëmarrës, përfshirë sipërmarrës, diplomatë, përfaqësues institucionesh dhe media.

**-Eventi "EksportOn", u mbajt në datën 28 janar 2026, në Tiranë.**

AIDA në zbatim të objektivave të saj për rritjen e konkurrueshmërisë dhe forcimit të potencialit eksportues të vendit, promovimit dhe mbështetjes së NMVM-ve, organizoi EksportON 2026, e cila u iniciua si një platformë gjithëpërfshirëse dialogu ndërmjet sektorit publik dhe privat, me pjesëmarrjen e gjerë të institucioneve qendrore, qeverisë, organizatave të biznesit, shoqatave sektoriale dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Eksportuesit shqiptarë përballen me një sërë sfidash që ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare, përfshirë politikat publike, certifikimet dhe standardet, aksesin në financim, mbrojtjen e markës, si dhe mungesën e një koordinimi efektiv ndërinstitucional.

Aktualisht, këto çështje adresohen në mënyrë të fragmentuar, pa një tryezë të përbashkët ku institucionet dhe bizneset të kenë mundësi të dialogojnë drejtpërdrejt mbi problematikat konkrete dhe të identifikojnë zgjidhje të përbashkëta.

**Qëllimi i zhvillimit të aktivitetit ExportOn**

Ky takim synonte të mbushte këtë boshllëk duke krijuar një hapësirë institucionale dialogu, ku:

- eksportuesit paraqesin drejtpërdrejt sfidat reale që hasin në praktikë;
- institucionet prezantojnë politikat, instrumentet dhe programet mbështetëse ekzistuese dhe të reja;
- identifikohen pengesat konkrete në procesin e eksportit dhe diskutohen zgjidhje praktike dhe të zbatueshme;
- forcohet koordinimi ndërmjet institucioneve publike, agjencive mbështetëse dhe sektorit privat.

Aktiviteti u organizua në dy tryeza paralele tematike, duke mundësuar diskutime të fokusuara dhe dialog të drejtpërdrejtë ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike:

- **Tryeza e Manifakturës**, e fokusuar në sektorët prodhues industrialë dhe eksportues;
- **Tryeza e Bujqësisë dhe Agro-përpunimit**, e fokusuar në zinxhirin bujqësor, sigurinë ushqimore dhe eksportet agroushqimore.

**EksportON 2026** konfirmoi nevojën për një dialog të strukturuar dhe të vazhdueshëm ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si dhe për politika të koordinuara që rrisin konkurrueshmërinë e

eksporteve shqiptare, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe integrimit evropian. Në këtë kuadër, AIDA mbetet një pikë referimi për lehtësimin e dialogut dhe bashkërendimin e mëtejshëm me aktorët përkatës, në mbështetje të vijimit të këtij procesi. Procesi do të vijojë me një **mekanizëm follow-up**, nëpërmjet të cilit AIDA, në forcim të koordinimit ndërinstitucional dhe dialogut publik–privat, do të ndjekë adresimin e këtyre çështjeve, qoftë përmes zgjidhjeve institucionale, qoftë përmes vendosjes së bazës për ndërhyrje konkrete programore nga institucionet përgjegjëse dhe partnerët donatorë.

**-Publikimi i pyetësorit për vlerësimin e nevojave për trajnim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, 22 Prill 2026.**

Në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka hartuar këtë pyetësor me qëllim identifikimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim kapacitetesh të këtyre ndërmarrjeve.

Ky proces synon të evidentojë nevojat kryesore për ngritjen e aftësive profesionale, si dhe të identifikojë fushat ku ndërhyrja përmes trajnimeve është më e domosdoshme për përmirësimin e performancës dhe konkurrueshmërisë së biznesit.

Rezultatet dhe gjetjet e këtij pyetësori do të analizohen dhe përpunohen në mënyrë të strukturuar dhe do t'u përcillen institucioneve përkatëse dhe partnerëve relevantë, me qëllim adresimin efektiv të nevojave të identifikuara, si dhe hartimin dhe zbatimin e programeve të përshtatura të trajnimit në mbështetje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Pyetësori është publikuar në rrjëtet sociale të AIDA-s dhe është shpërndarë në dataabazën e 400 kompanive sipas sektorëve që disponon AIDA. Afati I plotësimit të pyetësorit 1 muaj.

*3.Përkujdësja ndaj investitorëve (Takime aftercare)*

Gjatë periudhës Janar – Prill 2026, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka organizuar gjithsej 32 takime aftercare me investitorë vendas dhe të huaj që operojnë në Shqipëri. Këto takime janë zhvilluar në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm të AIDA-s për të mbështetur investitorët ekzistues, për të adresuar problematikat dhe nevojat e tyre, si dhe për të forcuar klimën e investimeve në vend.

*4.Nxitja dhe tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte* ***(Forume biznesi)***

Përgjatë periudhës Janar – Prill 2026, Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit ka organizuar, bashkëorganizuar dhe marrë pjesë aktive në një sërë forumesh dhe aktivitetesh ekonomike ndërkombëtare, me fokus promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh, forcimin e bashkëpunimit ekonomik bilateral dhe krijimin e mundësive të reja për partneritete ndërmjet bizneseve shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë, si më poshtë vijon:

- Forumi i Biznesit Shqipëri – Slloveni u organizua në Tiranë në bashkëpunim me SPIRIT Slovenia Business Development Agency dhe Institute for Strategic Solutions. Aktiviteti

mblodhi përfaqësues institucionalë dhe kompani nga të dy vendet për të diskutuar mundësitë e investimeve, rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimet tregtare. Gjatë forumit u nënshkrua gjithashtu Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet AIDA dhe SPIRIT Slovenia, me fokus promovimin e investimeve dhe zhvillimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet Shqipërisë dhe Slloveni.

- AIDA mori pjesë në Global Real Estate Summit 2026, i zhvilluar në datat 3–4 shkurt 2026 në Londër, Mbretëri e Bashkuar. Aktiviteti u organizua nga Entralon Club dhe mblodhi investitorë, fonde investimi, zhvillues të pasurive të paluajtshme, banka dhe përfaqësues të institucioneve publike nga vende të ndryshme. Pjesëmarrja e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në këtë samit kishte si qëllim promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe zhvillimit strategjik, rritjen e vizibilitetit të vendit përpara investitorëve ndërkombëtarë, krijimin e kontakteve të reja për nxitjen e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit institucional me aktorë ndërkombëtarë të sektorit.
- Forumi i Biznesit Japoni – Shqipëri u zhvillua në Tokio, në ambientet e Japan Bank for International Cooperation, në bashkëpunim me Japan Institute for Overseas Investment. Gjatë aktivitetit u prezantuan potencialet ekonomike dhe investuese të Shqipërisë në sektorë strategjikë si energjia, infrastruktura, turizmi dhe shërbimet, me qëllim tërheqjen e investitorëve japonezë dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Japoni.
- Forumi Ekonomik Shqipëri – Kosovë u organizua me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipëri dhe Kosovë. Diskutimet u fokusuan në sektorë si infrastruktura, energjia, tregtia dhe bashkëpunimi ndërmjet bizneseve të dy vendeve, duke krijuar mundësi për partneritete të reja dhe iniciativa të përbashkëta ekonomike.
- Forumi i Biznesit Shqipëri – Japoni në Tiranë u organizua me pjesëmarrjen e institucioneve publike, organizatave ekonomike dhe kompanive nga të dy vendet. Aktiviteti kishte në fokus prezantimin e mundësive të investimit dhe bashkëpunimit bilateral në sektorë strategjikë si energjia, infrastruktura, teknologjia dhe inovacioni.
- AIDA mori pjesë në Samiti IV i Diasporës, ku u diskutua roli i diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit dhe promovimin e investimeve. Aktiviteti shërbeu si një platformë për forcimin e lidhjeve ndërmjet biznesit shqiptar dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe për identifikimin e mundësive të reja të bashkëpunimit ekonomik.
- Kosova Finance Forum u zhvillua në datat 27–28 prill në Prishtinë, duke mbledhur përfaqësues të institucioneve publike, aktorë të sektorit financiar, komunitetin e biznesit dhe ekspertë ekonomikë nga rajoni dhe më gjerë. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në këtë forum, ku u diskutuan çështje që lidhen me zhvillimin ekonomik, klimën e investimeve, produktivitetin dhe sfidat demografike në Ballkanin Perëndimor.
- Konferenca e Biznesit Gjermani – Shqipëri u zhvillua më 30 prill 2026 me pjesëmarrjen e përfaqësuesve institucionalë dhe komunitetit të biznesit nga Shqipëri dhe Gjermani.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në këtë aktivitet duke organizuar ëorkshop-in me temë "Mundësitë dhe Lehtësitë për Investime në Shqipëri – si dhe Mbrojtja e Investimeve". Gjatë ëorkshop-it u prezantuan zhvillimet kryesore ekonomike në Shqipëri, sektorët me potencial të lartë zhvillimi, infrastruktura strategjike dhe instrumentet mbështetëse për investitorët e huaj në faza të ndryshme të procesit të investimit.

Përgjatë periudhës raportuese janar – prill 2026, AIDA ka nënshkruar 6 memorandime bashkëpunimi me agjenci homologe dhe partnerë të tjerë, si më poshtë vijon:

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe SPIRIT Slovenia Business Development Agency – 5 shkurt 2026**

Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri–Slloveni, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe SPIRIT Slovenia Business Development Agency nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, duke hedhur bazat për forcimin e bashkëpunimit institucional në fushën e investimeve dhe zhvillimin e projekteve konkrete me interes të përbashkët. Si agjenci homologe të promovimit të investimeve dhe mbështetjes së biznesit, palët synojnë të shkëmbejnë eksperienca dhe praktika më të mira, të nxisin lidhjet ndërmjet sipërmarrjeve dhe të mbështesin identifikimin e mundësive të reja për investime dhe bashkëpunime ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Slloveni. Marrëveshja synon gjithashtu promovimin e sektorëve me potencial zhvillimi dhe krijimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet aktorëve ekonomikë të dy vendeve.

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe Lidhja e Bizneseve të Kosovës – 26 shkurt 2026**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Lidhja e Bizneseve të Kosovës (LBK) nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit, duke formalizuar një kuadër bashkëpunimi institucional ndërmjet palëve. Marrëveshja synon forcimin e bashkëpunimit ekonomik, nxitjen e investimeve dhe zhvillimin e projekteve konkrete që kontribuojnë në thellimin e marrëdhënieve ekonomike dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të biznesit të Shqipërisë dhe Kosovë. Nëpërmjet këtij memorandumi synohet gjithashtu mbështetja e sipërmarrjeve për zgjerimin e aktiviteteve të tyre dhe krijimi i mundësive të reja për partneritete ndërkufitare.

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe Bulgarian-Albanian Business Chamber (BABC) – 4 mars 2026**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Bulgarian-Albanian Business Chamber (BABC) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe institucional ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja synon krijimin e një platforme të qëndrueshme për promovimin e investimeve, zhvillimin e lidhjeve të biznesit dhe nxitjen e shkëmbimeve tregtare mes Shqipërisë dhe Bullgari, duke mbështetur identifikimin e mundësive të reja për bashkëpunim dhe partneritete ekonomike.

Gjithashtu, memorandumi parashikon zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta promovuese dhe shkëmbimin e informacionit mbi sektorët prioritarë për investime.

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe 28Digital – 26 mars 2026**

Gjatë aktivitetit Match-Maker Albania, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe 28Digital nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me fokus forcimin e bashkëpunimit në fushën e inovacionit digjital dhe zhvillimit të SME-ve. Marrëveshja synon promovimin e startup-eve shqiptare dhe iniciativave të orientuara drejt teknologjisë, mbështetjen e inovacionit në sektorë strategjikë si bujqësia dhe agri-tech përmes zgjidhjeve digjitale dhe bashkëpunimeve europiane, si edhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për ndërtimin e ekosistemit të inovacionit, përfshirë ëorkshope, rrjete bashkëpunimi dhe shkëmbim praktikash më të mira ndërmjet bizneseve, institucioneve kërkimore dhe aktorëve të inovacionit. Memorandumi synon gjithashtu të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të SME-ve shqiptare dhe integrimin e tyre në tregjet dhe rrjetet ndërkombëtare të teknologjisë dhe inovacionit.

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe Oda Ekonomike e Kosovës – 27 mars 2026**

Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri–Kosovë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Oda Ekonomike e Kosovës nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, duke hedhur një hap konkret drejt forcimit të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja synon të lehtësojë bashkëpunimin institucional, të promovojë investimet dhe të krijojë më shumë mundësi partneriteti për bizneset shqiptare dhe kosovare, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe mbështetjes së sipërmarrjeve në sektorë me potencial zhvillimi. Gjithashtu, memorandumi parashikon intensifikimin e kontakteve ndërmjet komuniteteve të biznesit dhe promovimin e projekteve të përbashkëta me interes ekonomik.

• **Memorandumi i Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe EUBACCI – 31 mars 2026**

Në kuadër të inaugurimit të EUBACCI në Bruksel, më 31 mars 2026, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) me EUBACCI, me synim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe promovimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikë, si dhe tërheqjen e investimeve belge në Shqipëri. Marrëveshja synon të krijojë një kuadër bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit, mbështetjen e sipërmarrjes, promovimin e investimeve dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në funksion të ndërkombëtarizimit të bizneseve shqiptare. Nënshkrimi i këtij memorandumi përfaqëson një hap të rëndësishëm në zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimit ekonomik dhe në promovimin e Shqipërisë si një partner i besueshëm për investime dhe zhvillim ekonomik në tregun belg.

**5. Projekte të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë periudhës raportuese për vitin 2026**

Me hyrjen në fuqi të paketës ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshpejtuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik

Misionet e mësipërme realizoheshin nga Sektori One Stop Shop brenda Drejtorisë së Investimeve, por duke qenë se puna para dhe pas vlerësimit të një projekti investimi është masive, lindi nevoja për krijimin e Drejtorisë së Investimeve Strategjike, e krijuar rishtazi me miratimin e strukturës së re të AIDA, e cila përbëhet nga 2 sektorë:

1. Sektori i One Stop Shop
2. Sektori i Monitorimit

Në këtë aspekt, Drejtoria e Investimeve Strategjike:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy statuse te ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.
- monitoron zbatimin e planit të veprimit të Vendime të KIS nga ana e subjekteve dhe institucioneve.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitucional shumë funksional. Ligji i investimeve strategjike Nr.55/2015, i ndryshuar, ka shtyrë afatin e aplikimeve deri në 31.12.2026.

Në katërmujorin e parë të vitit 2026 rezulton se:

- Kërkesat e ardhura nga subjektet të cilat janë në fazë asistimi pranë AIDA për vitin 2026 janë 7 projekte në total, të cilat përfshijnë edhe letra interesi të ardhura rishtazi nga vitet e mëhershme. Aktualisht, subjektet janë takuar në mënyrë periodike nga stafi i AIDA duke u asistuar mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës që duhet të dorëzohet.

- Projekte të aplikuara për përfshirjen në procedura administrative të legjislacionit të investimeve strategjike me qëllim përfitim statusi strategjik, të cilat janë në proces vlerësimi janë 2 projekte në total.
- Në katër muajt e fundit, me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) janë miratuar gjithsej 3 projekte, nga të cilat 1 projekt ka marrë miratim statusi për herë të parë, ndërsa 2 projekte lidhen me shtyrjen e afatit të statusit strategjik.

| VITI | 2026 |
|---|---|
| **Projekte në fazë vlerësimi nga grupi operacional** | 2 |
| **Projekte të miratuara nga KIS** | 1 |
| **Projekte të refuzuara** | 0 |
| **Projekte në fazë asistimi** | 7 |
| **Total** | 10 |

- Lidhur me monitorimin e projekteve:

Aktualisht, vazhdon procesi i komunikimeve me subjektet të cilat kërkojnë asistencë lidhur me zbatimin e vendimeve të KIS. Gjatë katër mujorit të parë të vitit 2026 i janë dërguar shkresa monitorimi 11 subjekteve, me periudhë raportimi Qershor - Janar 2025, të cilëve i është kërkuar informacion lidhur me ecurinë e projektit në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Vendimit të KIS. Aktualisht, një pjesë e subjekteve kanë kthyer përgjigje. Në përfundim të procesit Sektori Monitorimit përgatit Raportin e Monitorimit.

**b) Performanca e produktit "*Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*" (shpenzime korente).**

AIDA për vitin 2026, do të menaxhoj fondin "Për zhvillimin e ndërmarrjeve", sipas përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022 "Për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme", i cili financohet nga buxheti i shtetit.
Vlera totale e këtij fondi e vënë në dispozicion për NVM-të është në masën 100,000,000 lekë.
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka publikuar në faqen e saj zyrtare datë 11.05.2026, thirrjen për "Mbështetje për Zhvillim Ekonomik" të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", për vitin 2026.
Kjo thirrje mbështet zhvillimin e NMVM-ve duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, standartizmin, inovacionin/rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm. Kjo thirrje synon mbështetjen e NMVM-ve që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të vendit.

Thirrja për aplikime do të qëndroj e hapur për 30 ditë kalendarike.
Shpallja e ndërmarrjeve fituese dhe procesi i disbursimit të fondit do të kryhet brenda vitit 2026.

**c) Përformanca e projektit "*Përmirësim sistemesh*" dhe "Aplikacioni Mobile Aftercare" nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231).**

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2026 nuk ka nisur realizimi i projekteve "Aplikacioni Mobile Aftercare" dhe "Përmirësime sistemesh". Me e-mailin e datës 26.03.2026, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka informuar Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) se të dy projektet ishin kategorizuar si "Fond i Ngrirë" me kod M040141, referuar shkresës nr. 2720/1 prot., datë 13.03.2026 të Ministrisë së Financave. Në vijim, AIDA, me shkresën nr. 642 prot., datë 16.04.2026, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ka kërkuar ç'ngurtësimin e fondeve buxhetore për projektet në fjalë. Më pas, me e-mailin e datës 12.05.2026 nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, është përcjellë miratimi për ç'ngrirjen e fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale, bazuar në shkresën nr. 7096/1, datë 28.04.2026 "Ç'ngrirje fondi për shpenzimet kapitale" të Ministrisë së Financave. Për sa më sipër, gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur realizim fizik apo financiar të këtyre projekteve, pasi fondet kanë qenë në statusin "Fond i ngrirë", duke pamundësuar fillimin e procedurave për zbatimin e tyre.

**d) Përformanca e projektit me financim të huaj, "EEN Albania" dhe projekti "TVSH për projekte me financim të huaj" nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231).**

- ✓ **Projektet me financim të huaj.**

Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim "EEN Albania" në buxhetin e AIDA-s për vitin 2026 është parashikuar financimi 3,000,000 lekë. Gjatë periudhës raportuese janë shpenzuar 520,778 lekë dhe aktivitetet kryesore do të zhvillohen gjatë muajve në vazhdim.

Në kuadër të projektit janë zhvilluar aktivitetet me treguesit si më poshtë:

**EXPOFOOD Athens 2026 – Athinë, Greqi | 14–16 Mars 2026**

Në kuadër të rrjetit Enterprise Europe Network (EEN), AIDA/EEN Albania mbështeti pjesëmarrjen e kompanive shqiptare Eno Fama Ëinery, Parajse Shtepie, Zdrava Group, Dua Caffe, Drizzi shpk, Bio Bess dhe Amaral në panairin ndërkombëtar EXPOFOOD Athens 2026, një nga eventet më të rëndësishme në rajon për sektorin agro-ushqimor dhe industrinë e ushqimit. Mbështetja e EEN konsistoi në koordinimin e pjesëmarrjes së bizneseve, promovimin e profileve të tyre ndërkombëtare, organizimin e takimeve B2B dhe facilitimin e kontakteve me partnerë potencialë nga tregjet europiane. Gjatë eventit, kompanitë zhvilluan një numër të konsiderueshëm takimesh biznesi me distributorë, importues dhe përfaqësues të industrisë ushqimore, duke krijuar mundësi konkrete bashkëpunimi dhe zgjerimi në tregjet ndërkombëtare. Një marrëveshje

partneriteti u finalizua gjatë eventit, ndërkohë që disa bashkëpunime të tjera janë aktualisht në proces negocimi.

**BIOFACH 2026 – Nuremberg, Gjermani | 10–13 Shkurt 2026**

AIDA/EEN Albania mbështeti pjesëmarrjen e kompanive shqiptare Ritch Doci, Ekoprod shpk, Natural Herb E.V.R shpk, Amel Extract dhe Fenix I.C në BIOFACH 2026, panairi lider botëror për produktet organike dhe bio. Nëpërmjet rrjetit Enterprise Europe Netëork, kompanitë përfituan mbështetje në promovimin ndërkombëtar, organizimin e takimeve B2B dhe identifikimin e partnerëve potencialë për eksport dhe bashkëpunim tregtar. Pjesëmarrja në event kontribuoi në rritjen e vizibilitetit të produkteve shqiptare bio në tregun europian dhe në krijimin e kontakteve të reja me importues, rrjete shpërndarjeje dhe aktorë të sektorit organik. Gjatë panairit u realizua një marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërsa disa diskutime të tjera për partneritete tregtare vijojnë në fazë zhvillimi.

**MACFRUT 2026 – Rimini, Itali | 20–22 Prill 2026**

Në kuadër të mbështetjes për ndërkombëtarizimin e SME-ve shqiptare, AIDA/EEN Albania mundësoi pjesëmarrjen e kompanive Zdrava Group, Desina Ballkan shpk, BM Polymer Group dhe Fragoland shpk në panairin ndërkombëtar MACFRUT 2026, i dedikuar sektorit të frutave, perimeve dhe teknologjive agro-industriale. Mbështetja e EEN përfshiu koordinimin e pjesëmarrjes, promovimin e profileve të kompanive dhe organizimin e takimeve B2B me partnerë potencialë europianë. Kompanitë pjesëmarrëse zhvilluan takime me importues, distributorë dhe kompani të teknologjisë bujqësore, duke krijuar mundësi për zgjerim të eksporteve dhe bashkëpunime të reja në zinxhirin agro-ushqimor. Një marrëveshje partneriteti u konkretizua gjatë eventit, ndërsa disa kontakte të tjera mbeten në proces diskutimi.

**MatchMaker Albania 2 – Tiranë, Shqipëri | 26 Mars 2026**

AIDA, në bashkëpunim me Enterprise Europe Netëork (EEN), organizoi edicionin e dytë të forumit MatchMaker Albania 2, platforma më e madhe kombëtare për nxitjen e investimeve, bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtarizimit të SME-ve shqiptare. Në fokus të sektorit "Smart Agriculture" morën pjesë kompani dhe institucione si Morava, Melesin, Kantina Shehi, Uka Ëine, Subashi, Kantina Arbëri, Jolla, Sagelo Match4Research, Albania Business Assurance, Holberton Metropolitan University of Tirana, Skaitech 3DSKAI, Keyo, Hero Game dhe Crimson. Nëpërmjet platformës B2B të eventit, EEN mundësoi organizimin e takimeve biznesore dhe rrjetëzimin ndërmjet kompanive shqiptare dhe partnerëve ndërkombëtarë. Eventi shërbeu si një hapësirë konkrete për prezantimin e inovacionit, teknologjisë dhe produkteve shqiptare, duke gjeneruar kontakte të reja biznesi dhe diskutime për partneritete strategjike, disa prej të cilave janë në proces avancimi drejt formalizimit.

**MUSE-X Event – në bashkëpunim me EEN Puglia**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet EEN Albania dhe EEN Puglia, është në proces organizimi eventi MUSE-X, i fokusuar në sektorët kreativë, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërkufitar. Aktiviteti synon të krijojë ura bashkëpunimi ndërmjet SME-ve, institucioneve dhe aktorëve të ekosistemit inovativ nga Shqipëria dhe Italia, përmes sesioneve tematike, takimeve B2B dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Deri më tani janë në proces zhvillimi dy marrëveshje partneriteti ndërmjet aktorëve pjesëmarrës, të cilat pritet të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

**Agriculture Day Expo – Lushnje, Shqipëri**

AIDA/EEN Albania mori pjesë në Agriculture Day Expo në Lushnje me një stendë dedikuar promovimit të shërbimeve të Enterprise Europe Netëork dhe mbështetjes për SME-të shqiptare. Gjatë aktivitetit u organizua një sesion informues mbi mundësitë e ndërkombëtarizimit, rrjetëzimit dhe aksesit në tregje të reja për bizneset shqiptare. Gjithashtu, EEN Albania përfaqësoi tre kompani shqiptare në kuadër të eventit, duke promovuar produktet dhe potencialin e tyre për bashkëpunime tregtare dhe investime. Aktiviteti kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit mbi shërbimet e EEN dhe krijimin e kontakteve të reja me aktorë të sektorit agro-ushqimor.

- ✓ **TVSH për projekte me financim të huaj**

Në zbatim të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit me financim të huaj "EEN Albania", gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti "*TVSH për projekte me financim të huaj*" detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën **31,603 lekë**, pra nga plani për këtë zë prej 4,000,000 lekë, realizimi është i ulët nga fakti se aktivitetet referuar projektit me financim të huaj në fjalë nuk kanë gjeneruar fatura me TVSH për të sjellë nevojë për kompensim nga ky fond.

***3. Performanca e treguesve kyc të përformancës me bazë gjinore, në nivel produkti***

Objekti i veprimtarisë të AIDA-s, në buxhetin e akorduar për mbështetje me grante për vitin 2026, konkretisht produkti jo projekt "Grante për mbështetjen e bizneseve" ka parashikuar trajtime me bazë gjinore. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes të subjekteve përfituese të granteve, Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporteve, do të kryej analizën se sa prej tyre kanë drejtuese femër.

Ndërkohë pjesa tjetër e aktiviteteve që zhvillon AIDA në rolin e promovueses të Shqipërisë si destinacion për investime, lidhet me targetimin dhe asistencën që ofrohet për investitorët vendas dhe të huaj, praktikë e cila nuk bën diferencim me bazë gjinore.

*4. Përformanca e buxhetit në nivel programi - AIDA*

- **REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE DHE KAPITALE SIPAS TAVANEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2026**

**Në lekë**

| Artikulli | EMËRTIMI | VLERA NË FILLIM TË VITIT NË BUXHET | VLERAT PAS NDRYSHIMEVE | FAKTI SHPENZIME THESAR<br><br>JANAR – PRILL | PËRQINDJA E REALIZIMIT (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| **600** | Paga | 68,363,000 | 68,363,000 | **21,513,828** | **31** |
| **601** | Sigurime Shoqërore | 9,482,000 | 9,482,000 | **3,511,648** | **37** |
| **602** | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 47,002,000 | 59,002,000 | **19,640,272** | **33** |
| **604** | Grante për mbështetjen e bizneseve | 100,000,000 | 100,000,000 | **0** | **0** |
| **606** | Transferta për Buxhetet Familjare & Individ | 48,000 | 148,000 | **16,000** | **11** |
| **A. Total 600-606** | | **224,895,000** | **236,995,000** | **44,681,748** | **19** |
| **231** | Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrore të trupëzuara (Buxheti Shtetit) | 8,450,000 | 8,450,000 | **31,603** | **0.4** |
| **231** | Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrore të trupëzuara (Financim i huaj) | 3,000,000 | 3,000,000 | **520,778** | **17** |

Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë
Tel: +355 (0)42251001, http://www.aida.gov.al, e-mail: info@aida.gov.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **B. Total 231** | **11,450,000** | **11,450,000** | **552,381** | **5** |
| **TOTAL (A+B)** | **236,345,000** | **248,445,000** | **45,234,129** | **18** |
| **Kapitulli 6** | **8,775,671** | **8,775,671** | **0** | **0** |

